



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 33 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të marrin pjesë në mbledhjen e I-rë të KPF-së e cila mbahet me datë: 16.01.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në ora 09:00.

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsytimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-dhjetor 2023,
4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt dhjetor 2023 – janar 2024,
5. Të ndryshme,

01Nr. 06-592 2024
Klinë, më 05.01 2024



Kryesuesi,
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Na osnovi člana 52 Zakona LSU Br. 03/L-040, člana 33 Statuta Opštine Klina, člana 15, 16 i 17 Pravilnika o radu Skupštine i Skupštinskih Komiteta, Predsedavajući Komiteta za Politiku i Finansije vrsi sledeće:

OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se članovi Komiteta za Politiku i Finansije, štampane mediji, lokalni radio da prisustvuju I-m sastanku za 2024 godinu dana 16.01.2024 od 09.00 sati u Sali Skupštine Opštine Klina

DNEVNI RED

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika prošlog sastanka,
3. Razmatranje izveštaja finansiskog poslovanja za period Januar-Decembar 2023,
4. Razmatranje zahteva KPF-u tokom Decembra 2023 i Januara 2024,
5. Razno,

01Br. 06-597/2024
Klina, 05.01/2024



Predsedavajući,
Fadil Gashi

KOMUNA KLINË

KRYETARIT: Zenun Elezaj

ASAMBLEË KOMUNALE

REPUBLIKA KOSOVA			
MUNICIPALITY OF KLINIA OPSTINA KLINIA			
Pranuar me dt. Received on Prilapjen datë 15.12.2023			
Njësia org. Unit	Titulli Poste	Shërbimi Department	Vlera Amount Shifra Number
Organ. Jod.			
01-463-42114/23			

K Ë R K E S Ë

Unë Mhill Lleshaj nga fshati Jagodë Komuna e Klinës, posedojë një fermë për te cilen kam pasur leje nga Drejtoria e Urbanizmit e cila leje me ka skaduar, ku une ju kam drejtuar edhe vitin e kaluar edhe këtë vit Komunes së Klines per vazhdimin e lejes. Objekti eshte me madhesi 15x12 dhe kërkoje nga organet kompetentet qe te me lejohet dhe të me jepet leja për shfrytezim .

Sa për njoftim une jetoje nga te ardhurat e kesaj ferme dhe asnje person nga familja jeme nuk është punesuar, ku burim i te gjitha te ardhurve familjare është nga kjo fermë.

Mbes me shpresë që kerkesa ime e perseritur do te me realizohet.

Klinë me dt: 05.12.2023

Parashtruesi i Kërkesës:

Mhill Lleshaj nga fshati Jagode K. Klinë

Tel: 048/618/001

Lleshaj



Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe
Mbrojtjeje të Mjedisit
Nr 351-152/09
Klinë më: 31.03.20009.

Ne bazë të nenit 20 alineja 2 të udhëzimit komunal nr 2000/14 për lejen e ndërtimit dhe shfrytëzimit të objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Klinës, nenit 89 të Statutit të Komunës së Klinës dhe nenit 171 të LPA-se, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit bijnë këtë:

Aktvendim

I LEJOHET z.Mhill Lleshaj nga Fshati Jagod komuna e Klinës ndërtimi i objektit të përkohshëm në ngastrën kadastrale 99/5 FL 135 zona kadastrale videj. Objekti do të jetë i përkohshëm dhe do të përvijet për mini ferme për kultivimin e lopëve dhe vijaçave.

Leje i lëshohet të lart përmendurit në afat prej 3 vitesh me mundësi vazhdimi nga ky organ.

Objekti do të jetë me dimenzione 15,00X12,00 Përdhës.

Tavani dhe konstruksioni i kulmit do të jetë prej drurit (pllaka nuk lejohet në këtë rast).

Kjo leje vlen 3 muaj prej ditës së lëshimit të këtij Aktvendimi.

Në qoftë se i lart përmenduri nuk fillon me punë në afat të caktuar me këtë aktvendim ky organ do të konstatojë si mos të ishte dhënë leja.

Arsytim

z.Mhill Lleshaj nga Jagoda Komuna e Klinës është paraqit me kërkesë organit dhe ka kërkuar që të epet leja e përkohshme për ndërtimin e një objekti që do të shërbejë për kultivimin e lopëve dhe vijaçave në fshatin Jagod.

Me shqyrtimin e kërkesës ky organ dhe dokumentacionit kontratës mes Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit mbi dhenjen e tokës me qira për 3 vite dhe dhenjen e pëlqimit nga ana e bashkë fshatarëve të tij se nuk ka ndonjë problem që i njëjti të mund të shfrytëzojë këtë hapsit për aktivitetin e lart përmendur.

Në bazë të cekur me lart është vendosur si në diapozitiv të këtij Aktvendimi.

Kundër këtij Aktvendimi pala e pa kënaqur ka drejt ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi përse këtij organi me 5 euro taks administrative Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë.

Me këtë Aktvendim të njoftohen: i lart përmenduri, inspeksioni dhe arkiva e kësaj Komune.

Shefi i ndërtimit
z.Flez Leshaj.





Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe
Mbrojtjeje të Mjedisit
Nr 351-152/1/09
Klinë më: 31.03.20009.

Ne bazë të nenit 13 alineja 2 të udhëzimit komunal nr 2000/14 për lejen e ndërtimit dhe shfrytëzimit të objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Klinës, nenit 89 të Statutit të Komunës së Klinës dhe nenit 171 të LPA-se, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit bje këtë:

K O N T R A T

E përpiluar me 27.03.2009 mese Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Klinës të cilën e përfaqëson z. Zeqir Morina në njërin anë (në cilin e qira dhensit) dhe.

z. Mhill Lleshaj me vendbanim në Jagodë në anën tjetër (si qira marres).

I

Qira dhensi ja jep qira marrësit lokacionin në shfrytëzim të përkohshëm në afat prej 3 tri vitesh prej datës së nënshkrimit të kësaj kontrate.

Qira marsi do të shfrytëzoj lokacionin përkohësisht për ndërtimin e një mini ferme për kultivimin e lopëve dhe vëçave në fshatin Jagodë ku edhe ndodhet kjo parcelë.

Pjesa e ngastrës nr 95/5 fl, 135 zo Videj në sipërfaqe prej 180m².

II

Qira marsi është i obliguar që qira dhensit të paguaj qiranë e vjetore për shfrytëzimin e lokacionit përkohësisht 180m² X 2.50 €, komunalit 180 X 1€ dhe ndërrimin e përkohshëm të kulturës prej tokës bujqësore në tokë ndërtimore 180 X 1€ gjithsej 810,00€.

III

Qira marsi është i detyruar që objektin ta ndërtoj pa pllakë masive ku konstruksioni i tavanit dhe kulmit do të jetë nga materiali i drurit.

IV

Qira marsi është i obliguar që 3 muaj para skadimit të kësaj konkrete të lajmëroj këtë organ që të ushtroj kërkesën për vazhdimin e kësaj kontrate.

Qira dhensi e ka të drejtën e vazhdimin dhe mos vazhdimin të kësaj kontrate duke vlerësuar gjendjen e nevojave të qira marsit si dhe korreksionin e qira marsit lidhur me detyrime që ka ndaj Komunës të paraparë me këtë kontratë.

V

Qira marsi është i detyruar që ta kthejë lokacionin në gjendje të mëparshme nëse të mjetit i kërkohet nga ky organ si rezultat i mos vazhdimit të kantatës mbi shfrytëzimin e perkohshëm të këtij lokacioni.

Nëse në kërkesën e qira dhensit, qira marsi nuk e liron lokacionin dhe rrënon objektin atëherë qira dhensi është i obliguar të veprojë vet dhe të bëjë rrënimin e këtij objekti duke liruar këtë lokacion, lidhur me këtë të gjitha shpenzimet do i takojnë qira marsit të cilat do të caktohen me konkluz të veçantë,

VI

Lidhur me mos marrëshjet e kësaj kantate palët mund të drejtohen edhe gjykatës komunale në Klinë.

VII

Kjo kontratë është përpiluar në 4 ekzemplar identik prej të cilave 2 i takon qira dhensit dhe 2 ekzemplar qira marrësit.

Qira marsi"

Mhill Lleshaj

Lleshaj

1030940772



Objekti

8839563701
VIDEJE pn /
VIDEJE 98 / 1
VIDEJE

Të Dhënat e Pronës
Të Dhënat Financiare
Ortofoto
Historia
Fotografite
Info Për Shitje

Kartolina shtatë e Jashtme të Pronës

Kategoria e vlerësimit: BUJQËSORE
Lloji i ndërtësës: E PANJOHUR
Nr i kateve: 2
Viti i ndërtimit: 2012
Kati i njësish: 1

8839563701 -15.10.2012

Fshije

8839563701 3086874 3086874_1 3086874_2





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

ÇERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

MBITË DREJTAT E PRONËS SË PALUAJTSHME / O PRAVIMA NA NEPOKRETNU IMOVINU / FOR THE IMMOVABLE PROPERTY RIGHTS

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office

Klinë/Klina/Klinë

Prona e Paluajtshme / Nepokretnu Imovinu / Immovable Property:

P-71011014-00099-5 *fp.m 135*

Data dhe Koha e Lëshimit / Datum i Vreme Izdavanja / Date and Time of Submission:

1/12/2009 - 2:55:46PM

Komuna / Opština / Municipality:

Klinë/Klina/Klinë

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

VIDEJË/VIDANJE/VIDEJË

A PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Titulli i Drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. ID Lb. ID ID No.	Vendbanimi Prebivalište Residence	Rruga Ulica Street	Nr. Br. No.	Kati Sprat Floor	Pjesa e pronës Dio imovine Part of scale	Azhuruar Ažurirano Updated
Posestnik Possessor	PRONË SHOQËRORË E KUVENDIT KOMUNAL	KC/11-0005299	KLINË				1/1	Nga/Od/From KC/ID

B NJËSIA E PRONËS SË PALUAJTSHME - JEDINICE NEPOKRETNJE IMOVINE - IMMOVABLE PROPERTY UNIT

Nr. i Njësise Br. Jedinice Unit No.	Llojet e Pronës Vista Imovine Property Class	Zona U/R Zone U/R	Shfrytëzimi Aktual Aktuelna Upotreba Actual Use	Vendi i quajtur Zvano mesto Place Name	Rruga Ulica Street	Nr. Br. No.	Kati Sprat Floor	Dhomat Sobe Rooms	Katet Spratovi Floors	Sipërfaqja (m ²) Površina m ² Area	L.Ndërtimore D.Lizencije C.License	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71011014-00099-5	Parcelë Parcela Parcel	Rural Rural Rural		SHEVARINA						6430	-	



Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr _____/23

Klinë, dt: _____/23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e XII e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 08.12.2023, me fillim nga ora 9:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, OSBE-në, drejtorë të drejtorive, zyrtarët dhe gjithë të pranishmit.
Gjithashtu, theksoi se përveç pikave të cilat janë për shqyrtim në rend të ditës, të futen si pika edhe dy kërkesa:

1.Draft-plani i punës së ekzekutivit për vitin 2024.

2.Draft -planifikimi i prokurimit për vitin 2024.

Më pas, Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

- 1. Arsyetimi i mungesave,**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 3. Shqyrtimi i propozimit për falje të qirasë komunale sipas propozimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim,**
- 4. Shqyrtimi i planit të punës së kuvendit dhe kalendarit për mbajtje të mbledhjeve për vitin 2024,**
- 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin nëntor-dhjetor 2023,**
- 6. Të ndryshme.**

Fadil Gashi, kryesues: Këto është mirë ne t'i procedojmë pa e përfunduar këtë vit dhe pjesën

tjetër të rendit të ditës veç e keni. Unë po hap debat rreth rendit të ditës me këto dy propozime që unë i shpalosa para jush, a ka dikush? Nëse s'ka, a po pajtoheni me rendin e ditës me këto dy kërkesa, kush është për?

Me 7 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua rendi i ditës.

1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, kryesues: Jemi të gjithë prezent.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush për procesverbalin e mbledhjes së kaluar?

Me 7 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i propozimit për falje të qirasë komunale sipas propozimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Fadil Gashi, kryesues: Fillimisht po ja kaloj fjalën drejtorit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues, përshëndetje anëtarë të KPF-së, për përfaqësuesin e policisë! Duke u bazuar mbi të drejtën tonë si pushtet lokal që bazohet në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale dhe në Ligjin për Financa Publike, dhe duke i pasur parasysh rrethanat në të cilat po kalojmë si vend dhe gjendjen e rënd që një kategori e shoqërisë tonë po e kalon, duke u nisur nga kategoritë sociale, disa kategori të luftës, dhe një rekomandim të auditorëve gjeneral që na është thënë edhe në takim me kryetarin kur kemi qenë, për një kategori e cila ka mbetur barrë e komunës që nga vitet e pasluftës e këtej, një borxh i pashlyer por që realisht komuna në një mënyrë apo në tjetrën nuk është më shumë kompetente për t'i marr ato të hyra. Është fjala për qiratë që kanë për taksa, që kanë paguar njerëzit për hapësira publike dhe që ato është një kohë e gjatë që nuk ekzistojnë dhe, është fjala për disa lokale që janë rrënuar kohë më parë dhe një kategori tjetër që është menaxhuar nga AKP-ja, e që në fakt kanë figuruar si obligime në komunë, dhe ne si Drejtori e Financave i kemi analizuar këto dhe pas krejt kësaj kemi ngrehur këtë çështje në Bordin e drejtorëve dhe aty jemi dakorduar që kjo kërkesë të vijë në

kuvend. Ne i kemi ofruar si propozim dhe është në dorën e juaj që ju ta vlerësoni dhe ta aprovoni apo jo, megjithatë do të ishte mirë që në kuadër të këtyre faljeve ne me i ndërtuar edhe kriteret dhe në kuadër të saj, në rastet sociale që realisht një pjesë e tyre e kanë një akumulim të obligimeve të borxheve ndaj komunës, me kriterin se nëse ne planifikojmë me i fal qiranë për një vit, me kushtin që ajo familje ose ai obligues me i paguar obligimet tjera. Nëse ka rast që nuk ka obligime, dmth nëse ka familje që e kanë kryer krejt obligimin e qirasë, me e fal për një vit në parapagim, dhe në njëfarë forme kështu vlen edhe për kategoritë e luftës por të njëjtin këtë kriter ndoshta mund ta zbatojmë edhe te këto tarraca dhe biznese. Kështu që, është një borxh që komunës i figuron edhe që është rritur borxhi në publik të komunës, në njëfarë forme pa të drejtë, sepse ato që kanë objekte ose lokale që janë menaxhuar nga AKP-ja s'kanë pasur obligim me hyrë në qira te ne, por edhe del një pjesë e lokaleve që janë rrënuar dhe te tarracat që kohë e gjatë nuk shfrytëzohen dhe nuk kanë pasur obligim m'i dalluar qiratë. Kështu që, ne sot e kemi sjell si propozim po me kushtin që në seancë me i specifikuar të gjitha rastet, qoftë të kategorive sociale, qoftë bizneseve, tarracave, qoftë të këtyre pronave që kanë qenë në AKP dhe vlerën totale dhe sa ka me qenë për një kategori, sa për njërën, sa për tjetrën.

Kështu që, ky është një propozim i yni, por kërkoj që ky rekomandim të kalojë për asamble, faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor, a ka dikush? Po, Tunë Deda?

Tunë Deda: Përshëndetje, kryesues, për ju, përshëndetje drejtor dhe gjithë të pranishmit këtu, përshëndetje përfaqësues të policisë! Kjo sipas mendimit tim është “thikë me dy tehe” sepse duke ju fal borxhet atyre që kanë mbetur ju hymë në hak atyre që kanë bërë pagesë, që kanë qenë të rregullt. Unë po e them mendimin tim personal, nëse unë jam për të shkuar në këtë orientim, nëse i falet borxhi, gjithëve duhet me këqyr me ua fal, por me kusht, me ua fal p.sh. për një vit, ose këta që kanë pasur obligim për lokale që e kanë pasur me qira, unë e di që e kanë bërë me qira prej komunës, me qira të lirë edhe i kanë shitur, jua kanë dhënë të tjerëve, i kanë marr paratë muaji për muaji për atë lokal. Nëse i ka marr 50 ai e ka shit 150 euro, ia ka dhënë me qira të tjetërkujt. Unë jam që t'ju falen p.sh. 30% të borxheve, me kusht që 70%-shi i borxheve me u paguar, e ata që nuk e bëjnë pagesën mos me jua fal, me i dërguar te përmbaruesi, m'i marr paratë se është e drejtë e komunës. Ata është dashur m'i paguar edhe ata çka kanë mbetur borxh për ato tarraca të lokaleve që kanë qenë të prishura, me këqyr, nëse ka qenë borxhi i përparshëm për pa ju rrënuar lokali atij, atë borxh me përqindje me ja fal, pasi ju ka rrënuar lokali s'është dashur me u ngarkuar, se s'ka pasur qysh me u ngarkuar ai me borxh kur s'ka punuar. Ky është mendimi im dhe mendimi personal i grupit që e përfaqësoj këtu.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Tunë, nuk bëhet fjalë për lokalet që i ka dhënë komuna në shfrytëzim, lokalet nuk jemi duke i falur, ne jemi duke i falur hapësirat publike dhe lokalet që janë rrënuar në kohën e mëhershme. Këto lokale nuk lirohen, lirohen qiratë për banesa sociale, jo për lokale që komuna i ka dhënë në shfrytëzim.

Tunë Deda: Unë këtu i shoh dy emra që nuk kanë pasur lokale tjera, por e kanë marr lokalin e komunës në shfrytëzim me qira dhe sot janë këtu të shkruar, për atë edhe e përmenda.

Ndoshta është lëshuar gabim këtu, po atyre që ju ka marr lokali, po them nuk duhet me ua fal borxhin komplet çka kanë pasur ata në kohën që kanë qenë duke punuar, po prej kohës që ju ka rrënuar lokali ata s'është dashur me u ngarkuar. Ndoshta edhe s'janë ngarkuar, por ndoshta edhe ec kamata, edhe ju ka shkuar ky borxh. Këtu po shoh që ka borxh në vlerë 20.000,00 euro. Kërkoj falje, s'është mirë me i liruar krejt, është mirë me i liruar me përqindje sikur po thua ti, për një vit, me kusht me u paguar borxhi i vjetër, po së pari me u paguar pastaj me u liruar, me jua bërë një njoftim. Ky është mendimi im, po ju në fund të fundit qysh ta sjellin vendim ata gjithë bashkë, ashtu po shkojmë.

Fadil Gashi, kryesues: A është fjala për banesa, apo edhe për lokale?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Lokalet, unë e thash, lokalet që janë rrënuar, që ka mbetur ndonjë, ende në evidencë të komunës edhe hapësirat publike që më nuk shfrytëzohen prej atyre pronarëve, edhe lokalet që kanë mbetur ende ndonjë prej atëhershmit. Kështu, unë e pata bisedë edhe me anëtarët e komitetit, ne munguam për shkak të vizitës që ishim në Itali, vizitës zyrtare. Realisht kohën e patëm shumë të shkurtër me e bërë specifikacionin për sot, po unë po kërkoj që kjo të hyjë në rend të ditës për seancë dhe të gjitha specifikacionet që duhet me shkrim do t'i keni me materialin për seancë.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, me 7 vota PËR, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim në Kuvend, por që deri në seancë të sjellët në detaje propozimi për faljen e qirasë komunale në mënyrë që kuvendi të mund të vendos përfundimisht rreth kësaj çështje.

4. Shqyrtimi i planit të punës së kuvendit dhe kalendarit për mbajtje të mbledhjeve për vitin 2024.

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi, theksoi se ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren për punë të Kuvendit është hartuar ky draft-plan i punës së kuvendit dhe kalendarit për mbajtje të mbledhjeve për vitin 2024, por që duhet të shqyrtohet dhe miratohet edhe nga Kuvendi.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-planit të punës së kuvendit dhe kalendarit për mbajtje të mbledhjeve për vitin 2024, me 7 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i draft-planit të punës së ekzekutivit për vitin 2024.

Lidhur me këtë pikë, referoi drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, z. Enver Berisha, i cili theksoi se draft-planit i punës është hartuar duke u bazuar në nevojat që kanë qytetarët e Komunës së Klinës të theksuara gjatë dëgjimeve buxhetore dhe kërkesave të vazhdueshme që bëjnë në komunë. Në këtë plan të punës, synimet dhe projektet e planifikuara të ekzekutivit të komunës së Klinës për vitin 2024 janë në funksion të realizimit të synimeve kryesore zhvillimore. Po ashtu, përcakton aktivitetet që do të ndërmerren këtë vit dhe kohën e aktivitetit për të bërë realitet vizionin që Klina gradualisht të bëhet një komunë ekonomikisht e zhvilluar me një administratë efikase, në shërbim të qytetarëve të vet dhe bizneseve, me një mjedis të pastër dhe atraktiv për të jetuar dhe punuar, duke treguar progres të vazhdueshëm në përmirësim të cilësisë së arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve publike. Andaj, kërkoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-planit të punës së ekzekutivit për vitin 2024, me 7 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 6. Draft -planifikimi i prokurimit për vitin 2024.

Labinot Morina, zyrtar i Prokurimit: Përshëndetje për të gjithë! Ne si zyrë e prokurimit kemi përgatitur planifikimin e prokurimit për vitin 2024. Planifikimi është bërë në koordinim me buxhetin komunal për vitin 2024 dhe kërkesat e dërguara nga njësitë kërkuuese që janë drejtoritë, e ky planifikim ka dalë të jetë diku mbi 5.000.000,00 për mallra dhe shërbime, pra për furnizime janë 23 procedura, që kap vlerën mbi 800.000,00 euro; për kategorinë e shërbimeve janë 13 procedura, që kap vlerën mbi 1.400.000,00 euro dhe; për komunë është 38 procedura, që kap vlerën mbi 3.500.000,00 euro. Këto nuk janë të përfshira me kontratë kornizë që janë me mbi 2 dhe 3 vjeçare, po ashtu, nuk janë të përfshira edhe grandet nga qeveria dhe grandet tjera. I bashkangjitur është edhe plani në detaj, kështu që, kjo është në vija të trasha, planifikimi i prokurimit për vitin 2024.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit shumë, a ka dikush diçka? Kush është për ta miratuar për kuvend?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-planifikimit të prokurimit për vitin 2024, me 7 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin nëntor-dhjetor 2024.

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, bazuar në kërkesat e parashtruara në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023 me anë të së cilave, Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, kishin kërkuar mbështetje financiare në vlerë të përgjithshme prej 26.390,00 euro ku pas shqyrtimit të këtyre kërkesave në KPF dhe më pas në Kuvend, duke pasur parasysh shumën e lartë të mjeteve financiare u rekomandua që kërkesat të shqyrtohen dhe të shikohet mundësia për mbështetje financiare me rastin e rishikimit të buxhetit për vitin 2023.

Fadil Gashi, kryesues: Me thënë të drejtën, ne kemi pasur një kërkesë në fillimvit, bile na kishin përkujtuar, na kishin përcjell edhe vendimin tonë. Ne ja kemi kthyer në rishikim të buxhetit, këtu është nga kuvendi ju kemi thënë se ju njoftojmë se pas shqyrtimit të kërkesës së lartpërmendur nga kuvendi, duke parë që shuma e kërkuar është e lartë dhe kjo vlerë nuk është e mundur të ndahet nga kuvendi i komunës pa planifikim buxhetor, kuvendi rekomandoi që kërkesa të shqyrtohet me rishikimin e buxhetit për vitin kalendarik 2023, çka ne nuk kemi pasur fare rishikim të buxhetit dhe kjo është e saktë, por ata e kanë përsëritur prapë. Është kërkesa e njëjtë me shumën e njëjtë dhe unë po i lexoj ndoshta 3 kërkesat, një nga një, po natyra e tyre është e njëjtë, me shumën dalluese: Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së i kërkon 8.480,00; Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së 8.560,00 dhe e fundit; Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, 9.350,00 euro. A ka dikush që mund të na ndihmojë në këtë rast?

Azdren Ramadani: Faleminderit, kryesues! Më së miri e di drejtori, se e ka buxhetin ky. Kështu që, nëse është mundësia na takon t'i ndihmojmë gjitha shoqatave, po gjithmonë duke e shikuar buxhetin sa mundet ky me dal.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Unë jam për ta rekomanduar po unë po bisedoj edhe me kryetarin, të shohim çka mund të bëjmë. S'do të thotë që tash pse është kërkesa në atë vlerë, me shkuar në atë vlerë. Le të rekomandohet për seancë.

Fadil Gashi, kryesues: Po, urdhëro, Tunë Deda?

Tunë Deda: Ndoshta nuk jam shumë i informuar po është dashur qeveria këtyre shoqatave t'ia caktojë për me ja dhënë statusin e njerëzve të punësuar aty që marrin rrogë nga shteti, edhe këto kërkesat që i bëjmë tash në komunë, është dashur nëse janë marr edhe për vitet e mëparshme

edhe e di që kanë marr, a kanë dhënë llogari kah i kanë dërguar ato mjete? Është dashur me dhënë llogari, se këto janë mjete të qytetarëve, taksa të qytetarëve, po zgjidhja më e mirë e mundshme nëse na dëgjon Ministria e Pushtetit Lokal, unë apeloj që këtyre shoqatave të ju dilet në ndihmë, se e meritojnë ta kenë problemin e zgjidhur por t'u dilet ndihmë prej qeverisë, e kanë mundësinë edhe kjo nuk është për krejt Kosovën, vetëm për Klinën. Kështu që, edhe unë pajtohem me dërguar në kuvend sa ka mundësi me ju ndihmuar, sa është mundësia se jo sa është kërkesa, se kërkesa, ndoshta dëshira jonë është me ja dhënë aq, po ku me i marr lekët, kaq!

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Kryesues, realisht është pak problematike sepse edhe këto janë OJQ, dmth është pak problem me jua ndarë paratë. Po ne mund të shikojmë bashkërisht, me i veçuar pak si kategori që e meritojnë, por po e them edhe njëherë, gjithmonë pas një konsulte që e bëjmë edhe me kryetarin edhe e çojmë aspektin e mjeteve tona ka mundemi edhe sa mund ta lëvizim, edhe në kuvend e vendosim sa e qysh.

Fadil Gashi, kryesues: Nëse ne i kemi mundësitë buxhetore unë nuk dyshoj që s'ka vullnet dikush prej nesh mos me ndihmuar, edhe ne me parë shumë seriozisht nëse janë mundësitë. Vlera është 26.390,00 tash, vlerë e saktë e përgjithshme, as nuk fitojmë as nuk humbim më shumë. Po le të merret edhe drejtori, edhe me kryetarin edhe me komplet ekzekutivin edhe koha është e mjaftueshme derisa ne të shikojmë në seancë. Por një përgjigje korrekte duhet ta kthejmë sepse ne një e kemi kthyer që do të kemi mirëkuptim deri në rishikim të buxhetit. Ne s'patëm rishikim për këtë vit fare se s'patë as nga niveli qendror rishikim të buxhetit. Ne e kemi miratuar buxhetin për vitin fiskal 2024, kjo kërkesë ka të bëjë vitin që vjen me buxhet të ri a mund të planifikojmë që këta kanë me u drejtuar me këto kërkesa. A ka dikush?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesave të parashtruara nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesat të dërgohen për shqyrtim në Kuvend.

Pika 8. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Të ndryshme, a ka dikush? Atëherë po ju falënderoj shumë, faleminderit për pjesëmarrje!

**Procesmbajtësja,
Monika Palushi**

**KRYESUESI,
Fadil Gashi**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

RAPORT I MENAXHIMIT FINANCIAR I KOMUNËS SË KLINËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

RAPORTI NËNTËMUJOR ËSHTË PËRGATITUR BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048, MBI
MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

1. Hyrje	3
1.1. Granti Qeveritar.....	3
1.2. Granti i të hyrave vetanake	3
1.3. Të hyrat vetanake të bartura.....	3
1.4. Performanca e shpenzimeve.....	4
2. Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për vitin 2023 duke i përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit	5
3. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-dhjetor 2023 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak	6
3.1. Realizimi i të hyrave për periudhën janar-dhjetor 2023 sipas muajve	8
4. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-dhjetor 2023 dhe krahasimi me vitin paraprak.....	10
4.1. Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar-dhjetor 2023 sipas kategorive ekonomike.....	11
5. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-dhjetor 2023 - raportit të shpenzimeve analitike sipas kodeve buxhetore në SIMFK	13

1. Hyrje

